



Përmbledhje Gama e Baterive

Bateritë EnerSys® PowerSafe® SBS XL me teknologjinë VRLA dhe me madhësi DIN janë dizajnuar që të sigurojnë performancë të jashtëzakonshme dhe jetëgjatësi marramendëse në aplikime ku rrjet elektrik është stabil. Duke kombinuar teknologjinë TPPL dhe përdorimin e katalizatorëve, rezultojnë në jetëgjatësi të lartë të PowerSafe SBS XL që redukton ndërrimet e baterive gjatë tërë jetëgjatësisë së infrastrukturave elektrike, duke siguruar një kosto të ulët totale të pronësisë si askush tjetër në industri.

Në kushte normale, jetëgjatësia e jashtëzakonshme e qelive SBS XL 320–3900 i dërgon benefitet e TPPL në tjetër nivel. Palët e interesuara dhe përdoruesit, posaqërisht në sektorët e Shërbimeve dhe Telekomit, më në fund kanë bateri me amperazh (Ah) të lartë që kombinon dizajnin klasik DIN dhe jetëgjatësinë e shtuar të operimit, së bashku me benefitet shumëfishta dhe të provuara të teknologjisë TPPL. Densiteti i madh i energjisë për instalime në hapësirë kompakte dhe jetëgjatësia e jashtëzakonshme e deponimit janë vetëm disa nga benefitet.

Prodhuar në një platformë moderne, gama e baterive SBS XL 320–3900 poashtu është e përshtatshme për përdorim në temperatura të larta, posaqërisht në industrinë e telekomit. Rritja e vazhdueshme e lëvizjes së të dhënave digjitale detyron kompanitë e telekomit që të shtojnë numrin e paisjeve në hapësirat e transmetimit, të cilat tashmë janë të mbingarkuara nga to. Nxehtësia që gjenerohet nga këto pajisje shtesë rrit nevojën për pajisje tjera të ftohjes, rrjedhimisht duke shtuar edhe më shumë shpenzimet financiare. Jetëgjatësia e jashtëzakonshme 10 vjeçare në 30°C e qelive SBS XL DIN iu mundëson operatorëve që të reduktojnë shpenzimet kapitale duke kursyer në metoda të ftohjes me kosto të ulët (p.sh. ftohja e lirë), poashtu duke reduktuar kostot operuese duke ngritur temperaturën e ajrit të kondicionuar.

Pa marrë parasysh temperaturat operuese, qelitë PowerSafe SBS XL janë zgjidhja ideale për ndërrimin e baterive të vjetra të përmasave DIN që operohen në aplikime me rrjet stabil. Qelitë EnerSys mund të instalohen në kabinetet apo raftet ekzistuese që të minimizohen shpenzimet kapitale.

Tiparet dhe Benefitet

- Teknologji e plumbit të pastër për më shumë kohë përdorimi
- Jetëgjatësi 20 vjeçare në 20°C – Jetëgjatësi 10 vjeçare në 30°C
- Të dizajnuara për aplikime në rrjete stabile të energjisë elektrike.
- Kapacitete të jashtëzakonshme të amperazhës-për orë: 320 deri 3900Ah
- Dizajn klasik sipas standardit industrial (DIN)
- Brez i gjerë i temperaturës operuese nga –40°C deri +50°C
- Instalim në pozicion vertikal ose horizontal
- Deponimi i baterive për 20 vjet në 20°C, për fleksibilitet gjatë implementimit të projekteve
- Kosto totale e ulët e pronësisë

Construction

- Teknologjia e provuar TPPL e optimizuar për jetëgjatësi përdorimi të shtuar
- Pllakat negative mundësojnë balancim perfekt me pllakat positive për të siguruar efikasitet optimal të rikombinimit.
- Ndarës nga fibra e xhamit, me rezistencë të ultë mikroporoze me absorbim dhe stabilitet të lartë
- Kontejneri dhe kapakët nga material ABS anti-zjarr i certifikuar me UL94 V-0, poashtu ky material është rezistent ndaj temperaturave të ngritura, dridhjeve dhe vibrimeve
- Acidi sulfurik i shkallës së lartë absorbohet plotësisht nga ndarësi, kjo rrit jetëgjatësinë në temperatura të larta dhe parandalon derdhjet në rast aksidenti
- Dizajni i provuar, me integritet të lartë dhe mbyllje të dyfishtë; kjo në mënyrë që të parandalohen derdhjet.
- Valvula vet-rregulluese të presionit në mënyrë që të ndalohet hyrja e oksigjenit atmosferik

- Teknologjia e katalizatorëve redukton humbjet e ujit; kjo rezulton në jetëgjatësi të shtuar operacionale
- Parandalues zjarri integral për siguri të shtuar operacionale

Installation & Operation

- Qelitë PowerSafe® SBS XL 2V DIN janë të dizajnuara që të përdoren në aplikime me rrjet stabil të rrymës
- Qelitë janë të dizajnuara që të instalohen në kabinate ose rafte
- Qelitë mund të vendosen në çdo pozicion, përveç në pozitën e përmbysur (ku terminalet janë poshtë). Për vendosje në mënyrë horizontale, referojuni manualit me instruksione
- Tensioni i rekomanduar i mbushjes: 2.29Vpc në 20°C, 2.275Vpc në 25°C
- Diapazon i gjerë i temperaturës operuese: -40°C deri +50°C
- 24 muaj jetëgjatësi deponuese në 20°C (12 muaj në 30°C)
- Mirëmbajtje e vogël: s'ka shtim uji

Standards


- Dizajnuar që të përputhet me IEC 60896-21/22
- Klasifikuar si "Jetëgjatësi e lartë" sipas udhëzuesit Eurobat
- Bateritë duhet të instalohen në përputhje me IEC 62485-2 dhe rregulloret lokale/nacionale
- Komponent i njohur nga UL
- Klasifikuar si bateri që nuk mund të ketë derdhje dhe aprovuar si produkt jo-i rrezikshëm për transportim tokësor, ujor, ajëror në përputhje me kërkesat ADR / RID, IMDG dhe IATA respektivisht
- Sistemet e menagjimit që mbikëqyrin prodhimin e qelive PowerSafe SBS XL 320-3900 janë të certifikuara me ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 45001

Specifikat e Përgjithshme


| Lloji I Baterisë | Tensioni Nominal (V) | Kapaciteti Nominal (Ah) | | Dimensionet Nominale (mm) | | | Pesha (Kg) | Rryma në qark të shkurtër (A) ⁽¹⁾ | Rezistenca Interne (mΩ) ⁽¹⁾ | Terminalet |
|------------------|----------------------|-------------------------------|------------------------------|---------------------------|--------------|-------------|------------|--|--|------------|
| | | C ₁₀ /1.80Vpc/20°C | C ₅ /1.75Vpc/25°C | Gjatësia(L) | Gjerësia (W) | Lartësia(H) | | | | |
| SBS XL 320 | 2 | 320 | 320 | 103 | 206 | 403 | 20.0 | 4776 | 0.44 | 2 x M10 F |
| SBS XL 400 | 2 | 400 | 400 | 124 | 206 | 403 | 24.0 | 5960 | 0.35 | 2 x M10 F |
| SBS XL 480 | 2 | 480 | 480 | 145 | 206 | 403 | 28.0 | 7152 | 0.29 | 2 x M10 F |
| SBS XL 580 | 2 | 580 | 580 | 124 | 206 | 520 | 33.0 | 6494 | 0.32 | 2 x M10 F |
| SBS XL 680 | 2 | 680 | 680 | 145 | 206 | 520 | 38.5 | 7613 | 0.28 | 2 x M10 F |
| SBS XL 780 | 2 | 780 | 780 | 166 | 206 | 520 | 44.0 | 8736 | 0.24 | 2 x M10 F |
| SBS XL 900 | 2 | 900 | 900 | 145 | 206 | 695 | 50.0 | 8744 | 0.26 | 2 x M10 F |
| SBS XL 970 | 2 | 970 | 970 | 145 | 206 | 695 | 56.5 | 11540 | 0.18 | 2 x M10 F |
| SBS XL 1200 | 2 | 1260 | 1260 | 210 | 191 | 695 | 78.0 | 14227 | 0.15 | 4 x M10 F |
| SBS XL 1500 | 2 | 1560 | 1560 | 210 | 233 | 695 | 93.5 | 17828 | 0.12 | 4 x M10 F |
| SBS XL 1800 | 2 | 1870 | 1870 | 210 | 275 | 695 | 112.0 | 21415 | 0.10 | 4 x M10 F |
| SBS XL 2700 | 2 | 2700 | 2700 | 212 | 397 | 820 | 163.0 | 32122 | 0.06 | 6 x M10 F |
| SBS XL 3100 | 2 | 3100 | 3100 | 212 | 487 | 820 | 190.0 | 36881 | 0.06 | 8 x M10 F |
| SBS XL 3900 | 2 | 3900 | 3900 | 212 | 576 | 820 | 239.0 | 46399 | 0.04 | 8 x M10 F |

Note: ⁽¹⁾ Matjet e marra përmes metodës IEC.

Skica Tipike të Dimensioneve




SBS XL 320 to SBS XL 970



SBS XL 1200 to SBS XL 1800



SBS XL 2700



SBS XL 3100 to SBS XL 3900



EnerSys World Headquarters
2366 Bernville Road, Reading,
PA 19605, USA
Tel: +1-610-208-1991
+1-800-538-3627

EnerSys EMEA
EH Europe GmbH,
Baarerstrasse 18,
6300 Zug
Switzerland

EnerSys Asia
152 Beach Road,
Gateway East Building #11-08,
Singapore 189721
Tel: +65 6416 4800

Kontakt: